



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE 14 MAJ 2023
PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA SOCIALISTE

I) TË DHËNAT E
AUDITUESIT

- | | | | |
|----------------|----------------------------------|-----------------|---------------------|
| 1. Emri | LEJLA LUAN SHAHU | 2. Datëlindja | 29/05/1965 |
| | (Emër, Atësia, Mbiemër) | | (dd/mm/vvvv) |
| 3. Adresa | Rruga Islam Alla, p.51/9, Tirane | | |
| 4. Tel/Cel | 0673589854 | 5. Email | lejladobi@yahoo.com |
| 6. Nr. Vendimi | 174 | 7. Datë vendimi | 22/01/2008 |

I) TË DHËNAT E
SUBJEKTIT ZGJEDHOR

- | | | | |
|-------------|-------------------|----------------------|-------------------------------|
| 1. Subjekti | PARTIA SOCIALISTE | 2. Shkronjat nistore | PS |
| 3. Kryetari | EDI RAMA | 4. Selia | Sheshi Austria, nr.91, Tirane |
| | (Emër, Mbiemër) | | |
| 5. NIPT | K71329002F | 6. Financieri | Dhurata Isufaj |
| | | | (Emër, Mbiemër) |

Emër Mbiemër

Lejla Shahu

Firma

Data

09/03/2024



I. TË DHËNAT E LLOGARARISË BANKARE TË POSAÇME PËR FUSHATËN ZGJEDHORE

Evidenca e hapjes së llogarisë/ve bankare të posaçme (data/dokumenti bankar)		23/02/2023
Emri i bankës		CREDINS BANK
Adresa e zyrës së bankës		Rruga Vaso Pasha, nr.8, 1001 TIRANE
Numri i telefonit të zyrës së bankës		355 46 700 777
Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës		info@bankacredins.com
Numri i llogarisë bankare		922832 leke 922834 usd 922835 eur
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare		Dhurata Isufaj
Dokumenti i lëvizjeve bankare (banke statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore		Bank statement nga data 24/10/2022 deri date 10/10/2023

Lejla Shahu

09/03/2024



a) bosh/mungon informacioni	Jo	Çfarë?	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	Të Ardhurat		
		Financime publike	42.833.467
		Donacione private	6.571.000
		Financim nga burimet e veta të partisë	62.968.160
		Të ardhurat nga kandidatët e listave shumemeërore	0
		Të ardhurat nga kandidatët për kryetar bashkie	10.969.230
		Huatë/Kreditë	0
	Shpenzimet		
		Mitingje/tubime dhe aktivitete në fushatë	6.520.100
		Materialet promionale	7.914.700
		Media	44.627.966
		Media Sociale	21.008.514
		Sondazhe	
		Botime/Publikime	
		Shpenzime zyre elektorale	2.203.707
		Transporti	2.949.068
		Konsulenca	
		Reklamime në natyre	
		Shpenzime administrative	20.847.572
		Shpenzime nga kandidatët e listave shumemeërore	0
		Shpenzime nga kandidatët për kryetar bashkie	10.844.395

Lejla Shahu

09/03/2024



II. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Fondi i marrë paradhënie	42.833.467	42.833.467
	Data e marrjes së fondit	10/05/2023	10/05/2023
	Kompensimi financiar paszgjedhor	0	0
	Data e marrjes së kompensimit financiar paszgjedhor	n/a	n/a
	Diferenca e kthyer	0	0
	Data e kthimit të diferencës	n/a	n/a
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	6.571.000	6.571.000
	Shuma e donacioneve në para	1.270.000	1.270.000
	Shuma e donacioneve në natyrë	5.301.000	5.301.000
	Përgatitet një listë e donatorëve		PO
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)		PO
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (shuma)		PO
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (data)		PO
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (donatori)		PO
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		PO
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		PO
	Respektimi i kufirit të donacionit		PO
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	62.014.360	62.014.360
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	55.355.000	55.355.000



	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	6.659.360	6.659.360
	<i>Botimet</i>	0	0
	<i>Shtypi i printuar</i>	0	0
	<i>Shitja e publikimeve</i>	0	0
	<i>Dhënia me qira</i>	0	0
	<i>Interesa bankare</i>	0	0
	<i>Transfertë nga llogaritë e partisë</i>	0	0
	<i>Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)</i>	0	0
	<i>Botimet</i>	0	0
	<i>Shtypshkronja</i>	0	0
	<i>Dhënia me qera</i>	0	0
	<i>Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)(shuma)</i>		PO
	<i>Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme(bank statement) (data)</i>		PO
4/ Shuma totale e të ardhurave nga kandidatët e listave shumëme		0	0
5/ Shuma totale e të ardhurave nga kandidatët për kryetar bashkie		10.969.230	10.969.230
6/ Huatë/Kreditë		0	0
	<i>Shuma e përgjithshme e raportuar</i>	0	0
	<i>Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)</i>	0	0
	<i>Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)</i>	-	-
	<i>Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)</i>		-
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
	<i>Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.</i>	Po	PO

Lejla Shahu

09/03/2024



A. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave paradhënie dhe paszgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në defiçit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?):
 - o Fondet e transferuara nga buxheti i shtetit janë në shumën 42.833.467 leke në datë 10/05/2023, në llogarinë e posaçme të hapur pranë bankës Credins me numër 922832 leke. Nga raporti i financimit të fushatës zgjedhore të ardhurat mbulojnë shpenzimet kryesore për këtë qëllim.
- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi.
 - o Në bazë të nenit 80 pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe në bazë të Vendimit 352 datë 13/04/2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është vendosur që koha falas për transmetimin e TV publik është 50 min dhe në radiot publike 30 min.
Kjo kohë e vënë në dispozicion falas nuk është faturuar nga televizionet dhe radiot publike dhe për rrjedhojë nuk është raportuar nga partia.
- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruar nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (*do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve*).

b/ Financimi nga burimet jo publike

- **Donatorët e lejuar:**
- Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
 - o Subjekti zgjedhor (Partia Socialiste) ka përdorur llogaritë e posaçme bankare pranë Bankës Credins me numër 922832, për të arketuar dhurimet monetare. Dhurimet monetare janë nga persona fizike. Dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën duke pohuar se nuk ndodhen në rrethanat e percaktuara në nenin 92/1 të Kodit Zgjedhor. Partia ka rregjistruar identitetin e qartë të dhuruesit në regjistrin e posaçem. Në total dhurimet monetare janë në shumën totale 1.270.000 leke. Lista e dhuruesve është si më poshtë:

Lejla Shahu

09/03/2024



1	DEGA KORCE	20.000	CASH	21/04/2023
2	DEGA KORCE	40.000	CASH	18/04/2023
3	DEGA KORCE	45.000	CASH	18/04/2023
4	DEGA KORCE	45.000	CASH	17/04/2023
5	DEGA KORCE	45.000	CASH	17/04/2023
6	DEGA KORCE	45.000	CASH	17/04/2023
7	DEGA KORCE	30.000	CASH	16/04/2023
8	DEGA KUKES	1.000.000	TRANSFERTE BANKARE XHEVAHIR SHEHU	07/04/2023

- Kandidatet per kryetare bashkie kane realizuar te ardhura ne shumen 10.969.230 leke. Keto te ardhura jane ne formen e fondeve jo publike si dhurime monetare. Jane perdorur llogarite bankare dhe ne formen e cash-it per arketimin e ketyre te ardhurave. Me poshte lista e dhurimeve per shumat mbi 100.000 leke:

1	206.000	ARIF TAFANI KANDIDAT BASHKIA BELSH
2	154.800	EDUART DURO KANDIDAT BASHKIA DEVOLL
3	200.000	ARISTOTEL KITO DHURUES BASHKIA DIMAL
4	138.910	ARMANDO SUBASHI KANDIDAT BASHKIA FIER FLAMUR GOLEMI KANDIDAT BASHKIA
5	249.920	GJIROKASTER
6	300.000	GJON LUFI DHURUES BASHKIA KAMEZ
7	700.000	RAKIP SULI KANDIDAT BASHKIA KAMEZ
8	300.000	ERALDO XHELILI DHURUES BASHKIA KOLONJE
9	381.000	SOTIRAQ FILO KANDIDAT BASHKIA KORCE KRESHNIK HAJDARI KANDIDAT BASHKIA
10	500.000	KUCOVE
11	360.000	PAVLIN ZEF NDREU DHURUES BASHKIA LEZHE MARINGLEN DISHA KANDIDAT BASHKIA
12	125.490	LIBRAZHD
13	100.000	ERGENT PRISHKA DHURUES BASHKIA LUSHNJE
14	230.250	GEZIM TOPCIU KANDIDAT BASHKIA MALIQ
15	359.750	SINAN ISMAILI DHURUES BASHKIA MIRDITE
16	400.000	GJON KOLA DHURUES BASHKIA MIRDITE
17	900.000	PRENG DEDAJ DHURUES BASHKIA MIRDITE
18	309.200	FATJON DURO KANDIDAT BASHKIA PATOS
19	300.000	ILIR LONDO DHURUES BASHKIA PERMET



20	120.000	NURI BELBA KANDIDAT BASHKIA PRRENJAS MAJLINDA BUFI KANDIDATE BASHKIA
21	300.000	ROSKOVEC TAULAND HAJDINI DHURUES BASHKIA
22	200.000	ROSKOVEC
23	150.000	MARCELA DELIALLISI DHURUES BASHKIA SHIJAK
24	250.000	BENET BECI KANDIDAT BASHKIA SHKODER
25	193.257	ERMAL DREDHA KANDIDAT BASHKIA VLORE

- o Ne fushaten e dates 24 shtator 2023 per zgjedhjen e kandidatit te bashkise Kukes, nuk jane realizuar donacione dhe shpenzime as nga Partia dhe as nga kandidati.
 - o Ndersa disa nga kandidatet per Kryetare Bashkie, nuk kane perdorur llogarine bankare, per arketimin e shumave mbi 100.000 leke, por kane plotesuar deklaraten dhe kane identifikuar dhuruesin. Mungesa e transaksioneve bankare per arketimin e ketyre te ardhurave jo publike, eshte ne shkelje te nenit 23/1 te ligjit 8580 date 17/02/2000 (i perditesuar 2020). Me poshte lista e dhuruesve me kete problematike:
 - ✓ Maringlen Disha bashkia Librazhd 125.490 leke arketuar cash
 - ✓ Kreshnik Hajdari bashkia Kucove 500.000 leke cash
 - ✓ Armando Subashi bashkia Fier 138.910 leke cash
 - ✓ Arif Tafani bashkia Belsh 206.000 leke cash
 - o Nga kontrolli i raportimeve te kandidateve per kryetare bashkie, rezulton qe Fran Tuci i bashkise Fushe Arrez dhe Safet Gjici i bashkise Kukes nuk kane deklaruar raportimin e tyre te fushates zgjedhore, per aresye te heqjes se lirise.
- Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë;
- Eshte respektuar tavani i dhurimit te percaktuar me ligj.

Lejla Shahu

09/03/2024



- **Burimet e palejuara**

- Nga verifikimet e donatoreve te lejuar eshte konstatuar qe:

- o Kandidati i bashkise Lezhe ka marre donacion nga personi fizik aksionar i shoqerise "N. S.S (Ndreu security services" shpk, shoqeri e cila ka perfituar fonde publike mbi vleren 10.000.000 leke, nepermjet nje kontrate me AKUK e cila ka shtrire efektet vetem gjate vitit 2021.

- **Kontributet në natyrë**

o **Vlerësimi:**

- Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;
- o Dhurimet ne natyre jane kontratat e lidhura per zyra zgjedhore ne deget e Partise Socialiste. Vleresimi eshte bere sipas cmimit te tregut per qiradhenje ne deget perkatese. Ka kontrata midis paleve dhe eshte plotesuar deklarata e dhurimit si dhe eshte percaktuar identiteti i dhuruesit. Shuma e dhurimeve ne natyre eshte 5.301.000 leke.
- o Kandidatet per kryetare bashkie kane realizuar dhurime ne natyre ne shumen e pergjithshme 475.541 leke. Ne kete shume perfshihet salla e dhene me qira ne shumen 331.041 leke per kandidatin e bashkise Sarande Oltion Caci.

- Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).

- o Nuk ka

- **Kufizimet**

- Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;

- o Eshte respektuar tavani i dhurimit te percaktuar me ligj.

- Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë – *si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?*)

- o *Nuk ka patur tejkalim te pragut edhe mbas konsolidimit te llogarive te selise qendrore te partise me ato te degeve.*

Lejla Shahu

09/03/2024



c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë

- o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra

1. Kuotat e anëtarësisë janë në total 6.659.360 leke. E detajuar sipas degeve është si më poshtë:

1	31.000	HAS	08/03/2023
2	16.000	FIER	12/03/2023
3	345.000	LEZHE	17/01/2023
4	40.000	DIVJAKE	21/01/2023
5	42.000	CERRIK	30/01/2023
6	10.500	PERMET	30/01/2023
7	120.500	DROPULL	11/01/2023
8	11.500	KLOS	14/01/2023
9	10.000	DEVOLL	04/01/2023
10	160.000	POGRADEC	02/05/2023
11	107.219	GRAMSH	09/02/2023
12	45.000	FUSHE ARREZ	09/02/2023
13	4.100	PUKE	04/04/2023
14	135.000	MALLAKASTER	30/01/2023
15	231.700	GJIROKASTER	14/03/2023
16	6.360	GJIROKASTER	27/04/2023
17	129.600	PRRENJAS	11/05/2023
18	52.500	KOLONJE	11/05/2023
19	87.860	MAT	30/01/2023
20	60.000	DIBER	09/04/2023
21	100.500	PATOS	20/02/2023
22	51.000	KAVAJE	30/01/2023
23	4.500	MALIQ	03/04/2023
24	224.750	LUSHNJE	30/03/2023
25	190.050	SHKODER	30/03/2023
26	562.260	ELBASAN	17/02/2023
27	5.000	BERAT	31/03/2023
28	13.000	DIMAL	31/03/2023
29	18.200	KORCE	31/03/2023
30	15.000	KAMEZ	31/03/2023
31	40.000	VLORE	09/04/2023
32	699.450	DURRES	11/04/2023
33	3.089.811	TIRANE	13/04/2023



- Botimet
 - Shtypi i printuar
 - Dhënia me qira
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
- Zyrat Qendrore
 - 1. Ne total nga zyra qendrore jane transferuar ne llogarine e posacme bankare shuma 55.355.000 leke, e cila se bashku me burimet e tjera te te ardhurave, ka mbuluar shpenzimet e fushates zgjedhore.
 - Degët lokale
 - 1. Nuk ka
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi "nxjerrje e llogarisë")**
- Egziston perputhshmeri midis natyres dhe shumes se te ardhurave midis deklarimit dhe dokumentit bankar.

d/ Huatë/Kreditë

- Identiteti i huadhënësit/ve
 - Kandidati per kryetar i bashkise Devoll, Gezim Topciu ka marre nje hua prej 5.000 eur, nga banka Union bank dega Korce.
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë).
 - Shuma e perdorur per fushate eshte 230.250 leke. Data e huase eshte 12 mars 2023
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë / huasë/ve (*problemi i huave të fshira- në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*)
 - *Data e shlyerje eshte 01 tetor 2023*
- Normat e interesit (*llogaritet tek shpenzimet si një shpenzim zgjedhor?*)
 - Norma e interesit eshte 3.2% dhe pjesa e interesit qe i takon shpenzimeve te fushates eshte 3,541 leke.

Lejla Shahu

09/03/2024



SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar	106.071.627						
Respektimi i kufirit të shpenzimit (Shuma e shpenzimeve nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.10019, date 19.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar)	Po						
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet/tubime dhe aktivitete në fushatë	4.448.000	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	4.448.000
Materialet promocionale	5.670.000	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	5.670.000
Media	44.621.606	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	44.621.606
Media Sociale	20.549.703	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	20.549.703
Sondazhe	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	0
Botime/Publikime	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	0
Transporti	2.286.155	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	2.286.155
Konsulenca	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	
Reklamime në natyrë	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	
Shpenzime zyre elektorale	0	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	
Shpenzime administrative	20.128.156	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	20.128.156



Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	2.072.100	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	2.072.100
Materialet promocionale	2.244.700	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	2.244.700
Media	6.360	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	6.360
Media Sociale	458.811	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	458.811
Sondazhet e opinionit publik	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	0
Botimet	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	0
Transporti	662.913	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	662.913
Konsulenca	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	0
Reklammat në ambientet e jashtme	0	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA	0
Shpenzime zyre elektorale	2.203.707	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	2.203.707
Administrative dhe të përgjithshme	719.416	PO	PO	NUK KA	NUK KA	NUK KA	719.416
Shpenzimet zgjedhore							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Pjeserisht
Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët e listave shumëmemërore							0
Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët per kryetare bashkie							10.844.497

Lejla Shahu

09/03/2024



B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve të fushatës (është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj për qëllime të fushatë zgjedhore): Për partitë politike 167.480.250 lekë ndërsa për kandidatët e pavarur 27.913.375 lekë → fokusohuni tek "fushatat e shumëfishta" të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

- Eshte respektuar kufiri i shpenzimeve te fushates si per partine politike ashtu eshe per kandidatet per kryetare bashkie.

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- **Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës (fokusohuni tek këto); ne total jane 6.520.100 leke, nga keto 2.072.100 leke jane realizuar nga deget e partisë:**

- o Shpenzime për vendin/ambjentin; 46.500
Ky shpenzim i referohet qirave te vendit ku eshte zhvilluar mitingu, dhe eshte shpenzim e degeve te partisë. Likujdimi i tyre eshte kryer pjeserisht cash dhe pjeserisht me banke. Keto shpenzime i perkasin periudhes se fushates.
- o Shpenzimet e zbavitjes/argëtimit; 2.549.600
Ky shpenzim i referohet faturave te leshuara per sherbime audivizuale per organizim eventi. Nga keto 1.589.600 leke eshte shpenzim i realizuar nga deget e partisë. Likujdimi eshte realizuar nepermjet bankes. Faturimi dhe likujdimi i perket periudhes zgjedhore.
- o Shpenzimet e pajisjeve; 3.588.000
Ky shpenzim i referohet faturave per karrige me qera si dhe flamuj te madhesive te ndryshme. Nga keto 100.000 leke eshte shpenzim i degeve te partisë. Likujdimi nepermjet llogarive bankare dhe shpenzimi i perket periudhes zgjedhore.
- o Shpenzimet për pijet; 0
- o Shpenzimet e reklamave/promocioneve; 336.000
1. Ky shpenzim i referohet sherbim brandimi i zyrave zgjedhore, dhe i perket degeve te partisë,
- o Shpenzimet e Transportit; 0
- o Shpenzimet administrative; 0

- Te gjitha shifrat e permenduar jane me TVSH perfshire dhe likujdimi eshte realizuar pjeserisht nepermjet llogarise se posacme bankare.

Lejla Shahu

09/03/2024



Materialet promionale

7.914.700 leke

- Materjalet promionale ne shumen 2.244.500 leke jane te llojit broshura, flamuj, bluza, kapele faturuar nga furnitore te ndryshem, shpenzim qe i perket degeve te partise. I gjithë shpenzimi është realizuar nga deget e partise, duke perdorur pjeserisht llogarite bankare. Keto materjale jane ne perputhje me udhezimin numer 6 date 23/03/2021 te KQZ.
- Materjalet promionale ne shumen 5.670.000 leke është e llojit "leter outdoor billboard" ne sasi 13.500 m2 e faturuar nga kompania "Digi Print-AL".

Nga raportet e monitorimit është vene re qe reklamat ne billboard te vendosura ne vendet e miratuara nga bashkia, mungon shenimi "prodhuar nen pergjegjesine ligjore te Partise Socialiste". Me vendimin e saj KSHZ nr.424 date 03/05/2023 ka urdheruar heqjen e gjithë materjaleve propagandistike qe nuk e permbajne kete shenim.

Nga komunikimi me kompanine "Digi Print-AL", jemi informuar qe problematika ne lidhje me shenimin e kerkuar nga ligji është zevendesuar me printime te reja me kete shenim te dukshem dhe te qarte ne to. Nuk ka patur asnje fature tatimore, dhe asnje pagese shtese e pajustificuar nuk është bere nga ana e partise ne drejtim te kesaj kompanie.

1. Te gjitha shifrat e permenduar jane me TVSH perfshire, dhe likujdimi është realizuar nepermjet llogarise se posacme bankare.

- Media

44.627.966 leke

- Operoret e radiotelevizioneve private kane respektuar kohen e pergjithshme te transmetimit te reklamave dhe tarifat per segmentet kohore te publikuara ne faqen e KQZ-se, sipas pikes 5 te nenit 84 te Kodit Zgjedhor.
- Ne baze te nenit 80 pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe ne baze te Vendimit 352 date 13/04/2023 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, është vendosur qe koha falas per transmetimin te TV publik është 50 min dhe ne radiot publike 30 min.

Kjo kohe e vene ne dispozicion falas nuk është faturuar nga televizionet dhe radiot publike dhe per rrjedhoje nuk është raportuar nga partia si fond publik per pasqyrimin e fushates zgjedhore.

- Media sociale

21.008.514 leke

- Mediat sociale i referohen si me poshte:
 1. "Sherbime marketingu" dhe " sherbime facebook", faturuar nga kompania HTTPPOOL shpk perfaqesuese e META ne Shqiperi.

Lejla Shahu

09/03/2024



Ky sherbim eshte ne shumen totale 4.104.156 leke. Sherbim marketingu eshte ne shumen 1,819,620 leke ndersa sherbim facebook eshte ne shumen 2,284,536 leke. Shpenzimi i perket qendres se partise dhe eshte paguar nga llogaria e posacme bankare. Dokumentet mbeshtetes jane marreveshja nr.051/2023 date 20/04 midis paleve si dhe faturat ligjore.

2. "Hapesira publicitare ne city lights Tirane" dhe "Transmetime spoti elektoral ekrane LED" nga kompania BNI shpk ne shumen 9.216.000 leke. Ekziston kontrata e bashkepunimit date 14/4/2023 midis paleve si dhe faturat ligjore. Shpenzimi i perket qendres se partise dhe eshte paguar nga llogaria e posacme bankare.
3. "Hapesire publicitare me qira gjate periudhes 14 prill deri 14 maj 2023" ne autostradat e Shqiperise, faturuar nga kompania Digi Print-AL ne shumen 2.400.000 leke. Ekziston kontrata e sipermarjes date 11/4/2023 si dhe faturat ligjore.
Nga raportet e monitorimit eshte identifikuar qe disa billborde, materjale propagandistike jane vendosur ne vende jo te percaktuara nga Bashkia. Keto materjale jane hequr me vendime te KQZ.
Nga komunikimi me kompanine "Digi Print-AL", jemi informuar qe problematikat ne lidhje me materjalet e vendosura ne hapesirat e ndaluara me ligj jane zhvendosur ne rruget nacionale . Nuk ka patur asnje fature tatimore, dhe asnje pagese shtese e pajustificuar nuk eshte bere nga ana e partise ne drejtim te kesaj kompanie. Hapesirat ne te cilat jane bere keto veprime jane:Durres, billbord pallati sportit "Ramazan Ngjela"; Elbasan tek Bulevardi Qendror; Gjirokaster tek Bulevardi 18 Shtatori; Autostrade, Aksi nacional Tirane. Durres, Rrogozhine, Kavaje dhe Lushnje
4. "Adaptim i 15 postera ne banera te animuar ne 25 portale", "targetim i banerave sipas 12 qarqeve ne Shqiperi" si dhe "hapesira publicitare ne 25 portale. Ky sherbim eshte faturuar nga kompania "DIGITAL BEE" shpk ne shumen 3.628.800 leke.
5. "Shpenzime facebook" ne shumen 1,659,558 leke paguar per portalin facebook . nga keto 458.811 jane shpenzime te kryera nga degjet e partise.
6. Te gjitha shifrat e permenduar jane me TVSH perfshire, dhe likujdimi eshte realizuar nepermjet llogarise se posacme bankare.

Lejla Shahu

09/03/2024



- **Sondazhe**
- **Botimet/Publikimet**
- **Transporti**

2.949.068 leke

- o "sherbim me shofer te dedikuar per 30 dite" faturuar nga kompania "ALBARENT", dhe blerje karburanti 10.000 litra ne shumen 1.770.000 me tvsh perfshire faturuar nga kompania "KASTRATI" shpk, si dhe biznese te tjera kane faturuar pjesen tjeter te ketij shpenzimi. Likujdimi eshte bere pjeserisht nepermjet llogarise bankare, dhe pjeserisht cash. Nga kjo shume 662.913 leke i takon degeve te partise

- **Konsulenca**
- **Reklamime në natyrë**
- **Shpenzime zyre elektorale**

2.203.707 leke

- o Shpenzimet per zyra zgjedhore mbeshteten ne kontrata me individe te cilet kane kontraktuar kundrejt cmimit zyrat ne funksion te fushates zgjedhore. I gjithë shpenzimi eshte realizuar nga deget e partise dhe i perkasin periudhes se fushates. Ne kete shume perfshihet edhe tatimi ne burim per qirate te cilat jane paguar rregullisht nga llogaria e posacme e partise.

Nga raportet e monitorimit eshte konstatuar qe disa zyra kane qene ne distance me afer se 300 m nga KZAZ, QV apo VNV. Me vendimet e saj KSHZ ka urdheruar mbylljen e zyrave zgjedhore te cilat jane hapur prane KZAZ, QV apo VNV.

Nga verifikimet jane konstatuar qe zyra zgjedhore ne Golem te Bashkise Lushnjes eshte me kosto 10.000 leke paguar nga vete kandidatja per kryetare bashkie, ndersa ne Bubullime dhe Krutje te Lushnjes jane me kontrata dhurimi, pra nuk ka kosto. Adresa e zyles zgjedhore prane QV shkolla Avni Rustemi ne Tirane, nuk u gjet kontrate qeraje, pra nuk ka kosto per tu raportuar.

- **Shpeznime administrative**

20.847.572 leke

- o Ne shpenzime administrative, rreth 94,5% ose 19.752.000 leke, jane blerje peme te llojeve te ndryshme. Furnitoret me te medhenj jane si me poshte:

<i>Trade And Construction Group</i>	<i>3.990.000</i>
<i>Green Farma sh.p.k</i>	<i>771.800</i>
<i>Green Farm sh.p.k</i>	<i>545.600</i>
<i>Aleksander Tafili</i>	<i>776.000</i>
<i>Syrja Vishkulli</i>	<i>850.000</i>
<i>Green Farm sh.p.k</i>	<i>666.000</i>
<i>Dean 09</i>	<i>1.200.000</i>
<i>Gjelberimi 2000 sh.p.k</i>	<i>543.600</i>
<i>Gjelberimi 2000 Sh.p.k</i>	<i>913.000</i>
<i>AJ Sh.p.k</i>	<i>870.000</i>
<i>Agro -Korani</i>	<i>1.314.688</i>

Lejla Shahu

09/03/2024



Ky shpenzim eshte realizuar nga Qendra e partise kundrejt faturave fiskale dhe kontratave te nenshkruara midis paleve. Shperndarja e tyre eshte bere ne 61 bashki me kontrata dhurimi nga Partia. Shifrat e mesiperme jane ne leke me tvsh perfshire. Shpenzimet administrative i perkasin periudhes se fushates. Pemet jane te llojit peme frutore, fidane, peme dekorative, lagerstoemia etj.si me poshte:

<i>lloji</i>	<i>cope</i>	<i>cmim</i>	<i>vlera me tvsh</i>
<i>fidane</i>	16.835	469	9.484.007
<i>peme dekorative</i>	1.594	1.487	2.843.939
<i>peme frutore</i>	5.602	595	3.996.878
<i>rrap</i>	246	4.997	1.475.000
<i>lagerstromia indica</i>	26	7.853	245.000
<i>lofate</i>	23	16.217	447.600
<i>likostremia</i>	6	4.167	30.000
<i>prunus</i>	12	15.000	216.000
<i>ilex cremata</i>	1	15.000	18.000
<i>cercis siliquatum</i>	15	25.000	450.000
<i>te tjera</i>	805	677,2	545.576
<i>total</i>	25.165		19.752.000

C / Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas kandidateve per kryetare bashkie dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- Shpenzimet e realizuara nga kandidatet per kryetare bashkie jane sipas kategorive te meposhtme. Jane realizuar ne perputhje me modelin e raportimit te financimit te fushates zgjedhore. Nuk ka shpenzime te paligjshme dhe keto shpenzime jane realizuar brenda periudhes se fushates zgjedhore. Jane realizuar pjeserisht cash dhe pjeserisht nepermjet llogarive bankare. Shpenzimet ne natyre i referohen shpenzime per salle me qira per kryetarin e bashkise Sarande Oltion Caci ne shumen 363.461 leke, dhe pjesa tjeter nga kandidate te tjere per shpenzime eventuale per shumen 112.500 leke.

2.144.746	MITINGJE
3.059.317	MATERJALE PROMOCIONALE
998.045	MEDIA
954.999	BOTIME
1.843.773	TRANSPORT
16.600	REKLAMIME NE NATYRE
1.351.374	SHPENZIME ADMINISTRATIVE
475.541	SHPENZIME NE NATYRE

Lejla Shahu

09/03/2024



- Ne fushaten e 24 Shtatorit 2023 per te zgjedhur kandidatin per kryetar te bashkise Kukes, nuk jane realizaura as donacione as shpenzime si nga partia ashtu edhe nga kandidati.

KUJDES: Për secilën kategori të shpenzimeve, analizoni:

- Natyrën zgjedhore të shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore;
- Ekzistencës dhe/ose zbulimit të shpenzimeve të paligjshme (keqpërdorimi i burimeve publike / blerja e votës). Sidoqoftë, këto shpenzime, të paligjshme nga natyra, duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogaritet si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- Shpenzimeve që janë bërë 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve duhen llogaritur dhe këto shpenzime si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- **Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ekzistojë një përputhshmëri me donacionet në natyrë.**
 - *Shpenzimet ne natyre jane 5.301.000 leke dhe i referohet kontratave per zyra zgjedhore te cilat jane dhuruar Partise Socialiste, dhe menyra e vleresimit eshte cmimi i tregut ne bashkite perkatese.*

Lejla Shahu

09/03/2024



I. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

➤ Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

○ Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit:

1. Disa nga kandidatet per Kryetare Bashkie nuk kane perdorur llogarine bankare per arketimin e shumave mbi 100.000 leke.

Me poshte po japim kandidatet per kryetare bashkie te cilet nuk kane hapur llogari bankare te posacme per arketimin e dhurimeve:

- Maringlen Disha bashkia Librazhd 125.490 leke arketuar cash
 - Kreshnik Hajdari bashkia Kucove 500.000 leke cash
 - Armando Subashi bashkia Fier 138.910 leke cash
 - Arif Tafani bashkia Belsh 206.000 leke cash
2. Kandidati i bashkise Lezhe ka marre donacion nga personi fizik aksionar ne shoqerine "N. S.S (Ndreu security services) shpk, shoqeri e cila ka perfituar fonde publike mbi vleren 10.000.000 leke, nepermjet nje kontrate me AKUK e cila shtrire efektet vetem gjate vitit 2021.

Lejla Shahu

09/03/2024



- Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiarë?
 1. Nga raportet e monitorimit është vënë re që reklamat në billboardet të vendosura në vendet e miratuara nga bashkia, mungon shenimi "prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste". Me vendimin e saj KSHZ nr.424 datë 03/05/2023 ka urdheruar heqjen e gjithë materjaleve propagandistike që nuk e përmbajnë këtë shenim.
Nga komunikimi me kompaninë "Digi Print-AL", jemi informuar që problematikat në lidhje me shenimin e kërkuar nga ligji është zëvendësuar me printime të reja me këtë shenim të dukshëm dhe të qartë në to.
 2. Nga raportet e monitorimit është identifikuar që disa billboardet, materjale propagandistike janë vendosur në vende jo të përcaktuara nga Bashkia. Këto materjale janë hequr me vendime të KQZ.
Nga komunikimi me kompaninë "Digi Print-AL", jemi informuar që problematikat në lidhje me materialet e vendosura në hapësirat e ndaluara me ligj janë zhvendosur në rruget nacionale . Nuk ka patur asnjë faturë tatimore, dhe asnjë pagesë shtese e pajustificuar nuk është bërë nga ana e partisë në drejtim të kësaj kompanie. Hapësirat në të cilat janë bërë këto veprime janë: Durrës, billboardi pallati sportiv "Ramazan Ngjela"; Elbasan tek Bulevardi Qendror; Gjirokastër tek Bulevardi 18 Shtatori; Autostrada, Aksi nacional Tirane. Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë.
 3. Nga raportet e monitorimit është konstatuar që disa zyra kanë qene në distance me afër se 300 m nga KZAZ, QV apo VNV. Me vendimet e saj KSHZ ka urdheruar mbylljen e zyrave zgjedhore të cilat janë hapur pranë KZAZ, QV apo VNV.
Nga verifikimet janë konstatuar që zyra zgjedhore në Golem të Bashkisë Lushnjës është me kosto 10.000 leke paguar nga vete kandidatja për kryetare bashkie, ndërsa në Bubullimë dhe Krutje të Lushnjës janë me kontratë dhurimi, pra nuk ka kosto. Adresa e zyrës zgjedhore pranë QV shkollë Avni Rustemi në Tirane, nuk u gjet kontratë qeraje, pra nuk ka kosto për tu raportuar.

Lejla Shahu

09/03/2024



B. PËRFUNDIMI

- o Çertifikimi me rezervë

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar raportimin e subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", që përfshin fondet e përfituara dhe të shpenzuara në fushatën zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore të 14 Maj 2023.

Sipas opinionit tonë, raportimi i subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzuara në fushatën zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore të 14 Maj 2023, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për opinionin me rezerve të raportit tonë, paraqesin me vertetesi, në të gjitha aspektet materiale, këtë raportim, në përputhje me aktet ligjore të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Baza për opinionin me rezervë

1. Disa nga kandidatet për kryetare bashkie nuk kanë përdorur llogaritë bankare për arketimin e fondeve jo publike për qëllime të fushatës zgjedhore. Kjo është në kundërshtim me nenin 23/1 të ligjit 8580 datë 17/02/2000 (i përditësuar 2020).
2. Kandidati i bashkisë Lezhe ka marrë donacion nga personi fizik aksionar në shoqërinë "N. S.S (Ndreu security services) shpk, shoqëri e cila ka përfituar fonde publike mbi vlerën 10.000.000 leke, nëpërmjet një kontrate me AKUK e cila shtrirë efektet vetëm gjatë vitit 2021. Kjo është shkelje e nenit 92/1 pika 3 e Kodit Zgjedhor.

Lejla Shahu

09/03/2024



Ne e kryem auditimin në përputhje me Ligjin 8580 date 17/02/2000 "Per partite politike" ndryshuar, Vendimtn nr.15 date 07/04/2023 te KRR "Per miratimin e rregullave per raportimin financiar te partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e te ardhurave dhe shpenzimeve te tyre gjate fushates zgjedhore, per organet e qeverisjes vendore", Ligji 10 019 date 29/12/2008 "Kodit Zgjedhor" i perditesuar, Kontrata nr.222 date 23/01/2024 "Per auditimin e partive politike te fondeve te periftuara dhe shpenzuara gjate fushates zgjedhore te 14 Maj 2023 dhe zgjedhjet vendore ne bashkine Kukes te dates 24/09/2023", si dhe akte nenligjore te KQZ ne lidhje me fushten zgjedhore per Organet e Qeverisjes Vendore 2023.

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Kontrates nr.222 date 23/01/2024 "Per auditimin e partive politike te fondeve te periftuara dhe shpenzuara gjate fushates zgjedhore te 14 Maj 2023". Ne jemi të pavarur nga Partia politike në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e kerkuar dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

LEJLA SHAHU

Audituese Ligjore
Lic.174 date 22/01/2008
Email:lejladobi@yahoo.com
Tel.:0673589854

Tirane me 09/03/2024

Raporti përfundimtar i auditimit